

2012



*100 Vjet Pavarësi*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Ministria e Financave**

# Raporti fiskal mujor

*Janar - Qershor, 2012*

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>TREGUESIT FISKALË PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2012 .....</b>	<b>2</b>
<b>ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2012 .....</b>	<b>2</b>
<b>Vështrim i përgjithshëm .....</b>	<b>2</b>
<b>Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera .....</b>	<b>5</b>
<b>Taksimi i konsumit (indirekt) .....</b>	<b>5</b>
<b>Taksimi direkt .....</b>	<b>7</b>
<b>ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2012 .....</b>	<b>10</b>
<b>Vështrim i Përgjithshëm .....</b>	<b>10</b>
<b>Shpenzimet Korrente .....</b>	<b>10</b>
Shpenzimet e Personelit.....	11
Shpenzimet për Interesa .....	12
Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes .....	12
Shpenzimet për Subvencione.....	12
Shpenzime të Pushtetit Lokal.....	13
Ndihma Sociale.....	14
<b>Shpenzimet Kapitale .....</b>	<b>14</b>

**TREGUESIT FISKALË PËR PERIU DHËN JANAR – QERSHOR 2012**

Nga të dhënat e Thesarit të Ministrisë së Financave, për 6mujorin e parë të 2012s, të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 161.6 miliardë lekë. Të ardhurat totale buxhetore ishin 5.0 përqind më të ulëta së parashikimi dhe 4.1 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 182.7 miliardë lekë, 1.8 përqind më të larta së planifikimi dhe 0.3 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet korrente janë rritur mbi baza vjetore me 1.6 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale kanë rënë me -11.9 përqind.

Defiçiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në këtë 6mujor në -21.1 miliardë lekë, 11 miliardë lekë më shumë se planifikimi, dhe 5,780 milionë më i ulët se e njëjta periudhë e një viti më parë. Defiçiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 652 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e defiçitit; 14.7 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brëndshme neto. Financimi i huaj neto i defiçitit ka qënë në nivelin 8.3 miliardë lekë, ose 3,065 milionë më pak se planifikimi.

Treguesit kryesorë të buxhetit të konsoliduar për periudhën janar-qershor

Milionë lekë	Janar - Qershor '11	Planifikimi Janar - Qershor '12	Janar - Qershor '12
TË ARDHURAT TOTALE	155,257	<b>170,059</b>	<b>161,574</b>
SHPENZIMET TOTALE <i>nga te cilat:</i>	182,166	<b>179,461</b>	<b>182,703</b>
SHPENZIMET KORRENTE	149,114	<b>149,203</b>	<b>151,572</b>
SHPENZIMET KAPITALE	33,052	<b>26,898</b>	<b>29,131</b>
BALANCA FISKALE	-26,909	<b>-9,402</b>	<b>-21,129</b>
BALANCA PRIMARE	-7,359	<b>12,745</b>	<b>-1,152</b>

**ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIU DHËN JANAR – QERSHOR 2012****VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM**

EMËRTIMI	6M-2007	6M-2008	6M-2009	6M-2010	6M-2011	6M-2012
<b>TOTALI TE ARDHURAVE (mln lekë)</b>	93,235	134,889	145,138	153,533	155,257	<b>161,574</b>
<b>Rritja vjetore</b>	-11.6	44.7	7.6	5.8	1.1	<b>4.1</b>

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 6-mujore arritën në 161.6 miliardë lekë, 5.0 përqind më pak se parashikimi për 6mujorin e vitit 2012 dhe 4.1 përqind më shumë se një vit më parë.

**Pesha specifike e çdo tatimi në totalin e të ardhurave tatimore**

		6MUJORI			
EMERTIMI		2011		2012	
		STRUKTURA			
		2011	2012	2011	2012
<b>II.</b>	<b>TË ARDHURAT TATIMORE GJITHSEJ</b>	<b>143,204</b>	<b>146,112</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>
<b>II.1</b>	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>108,701</b>	<b>110,856</b>	<b>75.9%</b>	<b>75.9%</b>
1	T.V.SH.	53,974	54,730	37.7%	37.5%
2	Akciza	17,187	17,125	12.0%	11.7%
3	Tatimi mbi Fitimin	11,312	8,787	7.9%	6.0%
4	Të Ardhura Personale	13,364	13,079	9.3%	9.0%
5	Taksat Nacionale dhe tjera	9,556	14,263	6.7%	9.8%
6	Taksa e Doganore	3,308	2,872	2.3%	2.0%
<b>II.2</b>	<b>Të ardhurat nga Pushteti Vendor</b>	<b>6,765</b>	<b>6,429</b>	<b>4.7%</b>	<b>4.4%</b>
<b>II.3</b>	<b>Të ardhurat nga Fondet Speciale</b>	<b>27,738</b>	<b>28,827</b>	<b>19.4%</b>	<b>19.7%</b>

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat u realizuan në masën 93.8 përqind ndaj parashikimit, ose rreth -7.3 miliardë lekë me pak nga afërsisht 118.2 miliardë lekë të planifikuara për periudhën, dhe 2.0 përqind më shumë se 6mujori i një viti më parë; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 6.4 miliardë lekë nga 7.8 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë (17.7% më pak) dhe me rënie vjetore prej 5.0 përqind; të ardhurat në fondet speciale arritën 28.8 miliardë lekë nga rreth 28.8 miliardë lekë të planifikuara, me rritje 3.9 përqind; të ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 1,552 milion lekë nga rreth 1,129 milionë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhë 13.9 miliardë lekë nga 10.9 miliardë të një viti më parë, me rritje vjetore -27.3 përqind dhe realizim të planit prej 128.9 përqind.

Sipas agjencive të mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 58.1 miliardë lekë, 4.6 përqind më pak se parashikimi për 2012, dhe me rritje 3.5 përqind kundrejt 6mujorit të vitit 2011. Sipas zërave të të ardhurave që mbledhin doganat, bie në sy performanca e rentës minerare në eksport, që është rritur mbi baza vjetore me rreth 168 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve të burimeve natyrore. Të ardhurat nga akciza në doganë rezultojnë me rënie prej -10.2 përqind kundrejt planit dhe -1.3 përqind në krahasim me një vit më parë. Të ardhurat nga TVSH në import janë 3.3 përqind më të larta se një vit më parë dhe -4.2 përqind më pak se parashikimi për periudhën 6mujore.

**Të ardhurat në Dogana sipas muajve dhe krahasimi me 2011**

Dogana total 6mujori I 2012	Muaji (milionë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2011
Janar	7,700	-47.1	-4.7
Shkurt	8,779	14.0	8.4
Mars	10,861	23.7	13.1
Prill	9,446	-13.0	0.8
Maj	10,408	10.2	5.0
<b>Qershor</b>	<b>10,945</b>	<b>5.2</b>	<b>-1.6</b>
<b>Total</b>	<b>58,138</b>		<b>3.5</b>

Administrata tatimore ka mbledhur 1.5 përqind më shumë të ardhura se 6mujori i vitit 2011 ose 1,204 milion lekë më shumë (përfshirë dhe kontributet). Totali i të ardhurave tatimore ka pasur një rritje prej 0.3 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe një mosrealizim të planit në masën -8.0 përqind, ndërsa të ardhurat nga kontributet janë rritur me 4.2 përqind mbi baza vjetore. Administrata tatimore ka rezultate të mira në mbledhjen e taksave nacionale për këtë periudhë krahasuar me një vit më parë me 44.6 përqind më shumë, ndërsa TVSH ka pasur një rënie prej -4.9% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë; Tatim Fitimi ka pasur një rënie prej -22.3 % në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë; Tatimi mbi të ardhurat personale ka pasur një rënie prej -2.6 % në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë; Akciza ka pasur një rritje prej 0.8 % në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### **Të ardhurat në Tatime sipas muajve dhe krahasimi me 2011**

<b>TATIME total 6mujori i 2012</b>	<b>Muaji (milionë lekë)</b>	<b>Në % ndaj muajit paraardhës</b>	<b>Në % ndaj 2011</b>
Janar	14,071	-3.3	1.1
Shkurt	12,016	-14.6	2.6
Mars	14,128	17.6	-2.1
Prill	13,252	-6.2	4.8
Maj	12,567	-5.2	-3.8
<b>Qershor</b>	<b>12,882</b>	2.5	7.9
<b>Total</b>	<b>78,916</b>		1.5

Nga totali i të ardhurave Tatimore sipas Sektoreve Ekonomikë shikojmë një rënie në sektoret e Prodhimit me -37.7%, Transportit me -20.6% dhe Ndërtimit me -5.4%. Peshat e sektorëve që kanë pësuar rënie në totalin e të ardhurave tatimore është 28 përqind. Sektorët që kanë pësuar rritje të të ardhurave tatimore janë Tregtia dhe Shërbimet përkatësisht 25.3% dhe 5.6%.

### **Të ardhurat tatimore sipas sektoreve kryesore të ekonomisë**

<b>Emërtimi</b>	<b>6muor 2011</b>	<b>6muor 2012</b>	<b>Ndryshimi</b>	<b>Subjekte pagues 2011</b>	<b>Subjekte pagues 2012</b>	<b>Ndryshimi</b>
	<i>(mln leke)</i>	<i>(mln leke)</i>	<i>ne %</i>	<i>numër</i>	<i>numër</i>	<i>ne %</i>
<b>Prodhim</b>	12,367	<b>7,704</b>	-37.7	7,799	<b>8,062</b>	3.4
<b>Ndërtim</b>	4,863	<b>4,600</b>	-5.4	6,227	<b>5,936</b>	-4.7
<b>Transport</b>	3,171	<b>2,519</b>	-20.6	2,035	<b>2,170</b>	6.6
<b>Tregti</b>	12,847	<b>16,096</b>	25.3	18,125	<b>18,758</b>	3.5
<b>Shërbime</b>	20,284	<b>21,422</b>	5.6	22,118	<b>24,794</b>	12.1
<b>Të tjera të paspecifikuara</b>	<b>43</b>	<b>100</b>	132.3	265	<b>540</b>	103.8

**TË ARDHURAT SIPAS TAKSAVE, TATIMEVE DHE BURIMEVE TË TJERA****TAKSIMI I KONSUMIT (INDIREKT)**

Nga TVSH janë mbledhur gjithsej për 6mujorin 54.7 miliardë lekë, ose 1.4 përqind më shumë se një vit më parë dhe -7.4 përqind më pak se parashikimi për vitin 2012.

**Tatimi mbi vlerën e shtuar 6Mujori në vite**

EMERTIMI	2009	2010	2011	2012
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Total (milion leke)	52,125	53,833	53,974	<b>54,730</b>
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Total (rritja vjetore ne %)	4.8	3.3	0.3	<b>1.4</b>
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Dogana (milion leke)	35,503	39,647	41,662	<b>43,019</b>
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Dogana (rritja vjetore ne %)	2.1	11.7	5.1	<b>3.3</b>
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Tatime (milion leke)	16,623	14,186	12,312	<b>11,712</b>
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Tatime (rritja vjetore ne %)	11.1	(14.7)	(13.2)	<b>(4.9)</b>

**Nga Administrata Doganore** janë mbledhur 43 miliardë lekë TVSH mbi mallrat e importuar, duke realizuar planin e periudhës në masën 95.8 përqind. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 78.6 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë të jenë 1.6 miliardë lekë më shumë ose 3.3 përqind më shumë. Për muajin qershor TVSH në doganë ka një mos realizim prej 754 milionë lekë ose 8.7 përqind më pak se parashikimi mujor. Të ardhurat nga TVSH në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara, çmimet në import dhe kursi i kembimit).

**Nga administrata tatimore** për periudhën Janar – Qershor janë mbledhur 11.7 miliardë lekë TVSH nga 14.2 miliardë lekë të planifikuara, që do të thotë -17.5 përqind më pak se parashikimi dhe -4.9 përqind më pak se një vit më parë. Për këtë periudhë, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 21.4 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja.

**Rimbursimi i TVSHsë** për periudhën 6mujore nga tatimet dhe doganat ka arritur shifren 3.2 miliard lekë me një ulje vjetore prej -0.2 përqind, sikurse pasqyrohet në tabelë.

Milionë lekë	2010	2011	2012	Në % ndaj 2011
TVSH e arkëtuar (bruto)	56,489	57,184	<b>57,916</b>	<b>1.3</b>
TVSH neto	53,833	53,974	<b>54,730</b>	<b>1.4</b>
Rimbursimi faktik i paguar	2,656	3,210	<b>3,186</b>	<b>(0.7)</b>

Në strukturën e të ardhurave tatimore që mbledhin tatimet, vihet re rënia e peshës specifike të TVSH-së ndaj totalit, nga 23.4 përqind në 6mujorin 2011 në 22.2 përqind për 6mujorin 2012. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e një rënie të TVSHsë së paguar në disa sektorë të veçantë. Sikurse e shikojmë dhe në tabelën e mëposhtme TVSH-ja e mbledhur sipas sektoreve ka pësuar një rënie të ndjeshme në sektorin e Prodhimit me -37.4%, sektorin e Transportit me -34.3% dhe në sektorin e Tregtisë me -7.3%. Rritjen më të madhe e ka pësuar sektori i shërbimeve me 28.1% e ndjekur nga sektori i ndërtimit me 1.2%.

**TVSH-ja sipas sektoreve kryesorë të ekonomisë**

Emërtimi	6mujor 2011	6mujor 2012	Ndryshimi	Subjekte pagues 2011	Subjekte pagues 2012	Ndryshimi
	<i>(mln leke)</i>	<i>(mln leke)</i>	<i>ne %</i>	<i>numër</i>	<i>numër</i>	<i>ne %</i>
<b>Prodhim</b>	3,804	<b>2,381</b>	-37.4	1,093	<b>1,242</b>	13.6
<b>Ndërtim</b>	2,586	<b>2,618</b>	1.2	1,644	<b>1,473</b>	-10.4
<b>Transport</b>	227	<b>149</b>	-34.3	277	<b>297</b>	7.2
<b>Tregti</b>	2,093	<b>1,941</b>	-7.3	3,024	<b>3,301</b>	9.2
<b>Shërbime</b>	3,608	<b>4,624</b>	28.1	3,932	<b>4,787</b>	21.7

**Akciza**

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën Janar – Qershor arritën në rreth 17.1 miliardë lekë; ose -9.8 % më pak se parashikimi sipas planit; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011, të ardhurat nga kjo taksë kanë rënë në masën 0.4 përqind.

**Të ardhurat nga akciza (06Mujori në vite)**

	2009	2010	2011	2012
Akciza gjithsej (mln lekë)	14,396	20,656	17,187	<b>17,124</b>
Ndryshimi vjetor (%)	-3.6	43.5	-16.8	<b>-0.4</b>
Dogane (mld lekë)	8,120	11,025	9,631	<b>9,505</b>
Tatime (mld lekë)	6,276	9,631	7,556	<b>7,619</b>

Të ardhurat nga akciza që mbledhin Doganat kanë një rënie prej 1.3 përqind kundrejt një viti më parë dhe – 10.2 përqind më pak se parashikimi për periudhën Janar-Qershor. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar, si dhe të mallrave të tjerë që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (sic janë mallrat që i janë shtuar listës së mallrave të akcizës). Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata e zhdoganimeve për periudhën ka qënë si vijon:

- Sasia e karburanteve të zhdoganuara për periudhën Janar – Qershor 2012 është 175 mijë ton, me rritje vjetore prej 2.2 përqind.
- Sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën Janar – Qershor 2012 është 1,531 ton, me rritje vjetore prej 18.3 përqind.
- Sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën Janar – Qershor 2012 është 13.9 milionë litra, me një rritje në krahasim me vitin e kaluar prej 1.8 përqind.
- Kafeja e zhdoganuar për periudhën Janar-Qershor ka qënë 9.2 përqind më shume se e njëjta periudhë e një viti më parë (3,535 ton);

**Të dhënat e zhdoganimeve të mallrave të forta 06Mujori në vite**

	2009	2010	2011	2012
Karburantet (ton)	193,913	220,257	171,408	<b>175,238</b>
Ndryshimi ne %		13.6	-22.2	<b>2.2</b>
Birre (000 litra)	15,669	15,296	13,629	<b>13,872</b>
Ndryshimi ne %		-2.4	-10.9	<b>1.8</b>
Cigare (ton)	1,731	1,764	1,293	<b>1,531</b>
Ndryshimi ne %		1.9	-26.7	<b>18.3</b>
Kafe (ton)	3,280	2,521	3,238	<b>3,535</b>
Ndryshimi ne %		-23.1	28.5	<b>9.2</b>

Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 7.6 miliardë lekë, me rritje vjetore - 0.8 përqind dhe realizim të planit të rishikuar në masën 90.7 përqind. Tatimet mbledhin akcizën mbi cigaret dhe pijet alkoolike, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO). Në aspektin e administrimit të akcizës për mallrat që pajisen me pullë fiskale, është në fazat e para të zbatimit projekti koncesionar për prodhimin dhe kontrollin e pullave fiskale (që nga muaji mars 2012). Përveç risive të tjera, menyra e re e administrimit parashikon vendosjen e pullës së akcizës edhe mbi produktin birrë (kod sigurie në rastin e birrave të prodhuara në vënd nga linjat e automatizuara të prodhimit). Fillimi i zbatimit të projektit mund të ketë patur ndikim të lehtë negativ në të ardhurat e mbledhura për këtë periudhë për shkak të ndryshimeve që ka sjellë për operatorët, deri sa procesi të konsolidohet. Në muajt e ardhshëm, në bazë të të dhënave të marra nga sistemi elektronik i administrimit të pullave, do të analizojmë ecurinë e të ardhurave nga produktet e veçanta dhe krahasimin me vitin e kaluar.

**TAKSIMI DIREKT****Tatimi mbi të ardhurat personale**

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 13 miliardë lekë për periudhën janar-qershor, me rënie prej -2.6 përqind në krahasim me 6mujorin e një viti më parë dhe me realizim të planit për vitin 2012 në masën 94.1 përqind.

**Tatimi mbi të ardhurat personale sipas komponenteve**

Të ardhura, milionë lekë	06mujor 2011	06mujor 2012	Ndryshimi %
<b>Tatimi mbi te ardhurat personale gjithsej</b>	<b>13,368.2</b>	<b>13,022.8</b>	<b>-2.6</b>
Paga sektori publik	4,364.4	<b>4,453.0</b>	2.0
Paga sektori jo publik	4,424.3	<b>4,643.7</b>	5.0
Interesa	1,423.3	<b>1,484.8</b>	4.3
Dividendë	383.4	<b>480.7</b>	25.4
Shitje pasuri e paluajtshme	1,037.3	<b>121.8</b>	-88.3
Te tjera	1,735.5	<b>1,838.8</b>	6.0



### Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 6mujorin 2012 arritën në rreth 8.8 miliardë lekë nga 11.3 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rënie të ndjeshme prej -22.3 përqind, dhe -26.7 % më pak se plani i periudhes Janar-Qershor 2012.

Tatim fitimi 2012	Muaji (milione leke)	Ne % ndaj muajit paraardhes	Ne % ndaj 2011
Janar	1,011	-39.4	-22.4
Shkurt	1,059	4.7	-4.9
Mars	2,923	176.0	-26.4
Prill	1,355	-53.6	2.7
Maj	1,340	73.5	-41.5
<b>Qershor</b>	<b>1,099</b>	<b>-42.5</b>	<b>-16.5</b>
<b>Total</b>	<b>8,787</b>	<b>119</b>	<b>-22.3</b>

Në rezultatin e të ardhurave për tatim fitimin për periudhën janar-qershor këtë vit ka ndikuar rënia e derdhjes së tatim fitimit nga ndërmarrjet shtetërore me -79.5% krahasuar me një vit më parë ose 1.4 miliardë lekë më pak (vecanërisht rezultatet negative të KESH sha). Pesha e tatim fitimit nga ndërmarrjet shtetërore në total për 6mujorin është vetëm 4.3% krahasuar me 16% që ka qënë në 6mujorin e parë të vitit 2011. Përsa i përket sektorit privat të ardhurat nga tatim fitimi janë ulur me 11.4% por në të njëjtën kohë në korrelacion të zhdrejtë sektori privat ka rritur peshën e tij specifike në të ardhurat e Tatim Fitimit për periudhën 6mujore nga 84% në vitin 2011 në 96% për 6mujorin e vitit 2012. I vetmi sektor që ka pësuar rritje në këtë periudhë ka qënë sektori i Tregtisë me 4.2 përqind më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Rënie më të madhe në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë e ka shënuar sektori i prodhimit me -45.2% i pasuar nga sektori i transportit me -20.2% sektori i ndërtimit me -18.8 % dhe sektori i shërbimeve me -16.1%

### Tatim Fitimi sipas sektorevë kryesorë të ekonomisë

Emërtimi	06mujor 2011	06mujor 2012	Ndryshimi	Subjekte pagues 2011	Subjekte pagues 2012	Ndryshimi
	<i>(mln leke)</i>	<i>(mln leke)</i>	<i>ne %</i>	<i>numër</i>	<i>numër</i>	<i>ne %</i>
<b>Prodhim</b>	3,627	<b>1,986</b>	-45.2	1,700	<b>1,723</b>	1.4
<b>Ndërtim</b>	1,750	<b>1,421</b>	-18.8	1,722	<b>1,641</b>	-4.7
<b>Transport</b>	228	<b>182</b>	-20.2	416	<b>433</b>	4.1
<b>Tregti</b>	2,005	<b>2,090</b>	4.2	4,641	<b>4,851</b>	4.5
<b>Shërbime</b>	3,705	<b>3,107</b>	-16.1	1,680	<b>1,824</b>	8.6

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 1.1 miliardë lekë, me rënie vjetore prej -36.5 përqind dhe plani i periudhës është realizuar në masën 63.5 përqind

### Taksimi i pasurisë

Për qëllime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat, mbi tokën bujqësore dhe taksën e kalimit të pasurisë së paluajtshme. Për 6mujorin taksat mbi pasurinë arrijnë në 1.6 miliardë lekë nga 1,205 milionë lekë të parashikuara dhe 56.4 përqind më të larta se një vit më parë.

### Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale në total për periudhën, janë 14.3 miliardë lekë nga 10.9 miliardë lekë të parashikuara për periudhën janar - qershor. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash kanë pësuar një rritje prej 49.3 përqind kjo si pasojë e reformës fiskale të ndërmarrë për këto grup taksash në vitin e kaluar.

### Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën janar – qershor janë rreth 2.9 miliardë lekë, -13.2 përqind më pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 377 milionë lekë, ose -11.6 përqind.

### Të ardhura të tjera nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën janar – qershor arritën në 6.4 miliardë lekë nga 7.8 miliardë lekë të planifikuara, ndërsa kundrejt 6mujorit të vitit 2011 të ardhurat janë ulur me 336 milionë lekë (rreth 5.0 përqind më pak). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogel dhe taksat mbi pasurinë për të cilat folëm më lart) kanë mbledhur rreth 3.7 miliardë lekë nga 4.9 miliardë lekë të parashikuara, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar këto taksa kanë pësuar një rënie prej -6.8 përqind.

### Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat në fondet speciale për periudhën janar – qershor 2012 arritën në 28.8 miliardë lekë, me një rritje prej 3.9 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe 0.2 përqind më shumë se parashikimi për periudhën. Ky grup të ardhurash përbën rreth 19.7 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë me 0.4 pikë rritje duke e krahasuar me peshën e të njëjtës periudhë në vitin e kaluar. Nga totali i fondeve speciale, rreth 28.1 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 750 milion lekë të ardhura për kompensimin në vlerë të pronarëve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 24.5 miliardë lekë, me rritje vjetore 1.3 përqind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 3.6 miliardë lekë, 35.9 përqind më shumë se 6mujori i një viti më parë.

Përsa i takon bazës së taksueshme, nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për periudhën 6mujore rezulton se: në total ka një rritje të numrit mesatar të të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve (sektor shtetëror dhe sektori privat) prej 2.8 përqind, ose rreth 11.6 mije njësi, kundrejt mesatares 6mujore të 2011 nga ku sektori i tregtisë dhe shërbimeve patën rritje përkatësisht me 3.4 % dhe 6.7 %.


### Numri mesatar i të punësuarve për efekt të derdhjes së kontributeve

	6-mujor 2011	6-mujor 2012	Ndryshimi ne %
Ndërmarrjet Buxhetore	137,362	138,204	0.6
Ndërmarrjet Shtetërore	22,141	20,537	-7.2
Subjektet Private T.V.SH.	180,322	186,471	3.4
Subjektet Biznes I Vogël	71,190	77,415	8.7
<b>Total</b>	<b>411,015</b>	<b>422,626</b>	<b>2.8</b>

## ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR – QERSHOR 2012

### VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit prill 2012, arritën në rreth 182.7 miliardë lekë, nga rreth 179.5 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar në rreth 101.8 përqind të parashikimit të periudhës ose me një tejkalim prej rreth 3.2 miliardë lekë. Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore për periudhën janar – qershor 2012 rezultojnë rreth 537 milionë lekë më shumë ose rreth 0.3 përqind më të larta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute si dhe ritmi i rritjes së tyre gjatë periudhës janar-qershor, në disa vite, jepet në grafikun e mëposhtëm.




Në analizën e shpenzimeve për periudhën janar - qershor 2012 duhet mbajtur parasysh fakti se në realizimin faktik të tyre, janë përfshirë edhe shpenzimet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit.

- Fondi rezerve i Këshillit të Ministrave, i planifikuar për vitin 2012, në 2.0 miliardë lekë, deri në fund të muajit qershor, është ekzekutuar në rreth 545.6 milionë lekë, nga të cilat rreth 34.1 milionë lekë për shpenzime personeli, rreth 440.6 milionë lekë për shpenzime të tjera korrente dhe rreth 70.9 milionë lekë për investime.
- Fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit, i planifikuar në rreth 2.66 miliardë lekë, deri në fund të muajit qershor 2012, është përdorur në rreth 2.1 miliardë lekë, nga të cilat 2.0 miliardë lekë janë dhënë në formën e huasë KESH-it dhe 99.6 milionë lekë në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së takses së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimet, tek njesitë e qeverisjes vendore.


### SHPENZIMET KORRENTE

Shpenzimet korrente në fund të muajit qershor 2012, kanë arritur në rreth 98.1 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 30.4 përqind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 3.5 miliardë lekë më të larta ose rreth 3.7 përqind më shumë.




**Shpenzimet e Personelit**

Brenda shpenzimeve korrente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 22.3 përqind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës janar - qershor 2012, rezultojnë rreth 1.4 përqind mbi parashikimin e periudhës. Kundrajt planit vjetor këto shpenzime në fund




të muajit prill janë realizuar në rreth 47.7 përqind të tij, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shpenzimet e personelit rezultojnë rreth 828 milione lekë më të larta, ose rreth 2.5 përqind më shumë.

Shpenzimet për paga janë rreth 2.5 përqind më të larta se një vit më parë ose rreth 705 milionë lekë më shumë se një vit më parë, ndërkohë që shpenzimet për sigurimet shoqërore janë rreth 123 milionë lekë më shumë ose rreth 2.7 përqind më të larta se një vit më parë. Këto dy grupe shpenzimesh janë realizuar respektivisht 2.0 përqind dhe 0.7 përqind mbi nivelin e parashikimit të periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë përkatësisht shpenzimet për paga rreth 49.8 përqind e planifikimit vjetor dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore në rreth 48.8 përqind të këtij planifikimi.




### Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet për interesa që përfaqësojnë rreth 13.2 përqind të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara gjatë periudhës janar- qershor 2012, rezultojnë me një kursim kundrejt parashikimit të periudhës, prej rreth 2.2 miliardë lekë, rrjedhojë kjo e kursimit për rreth 1.4 miliardë lekë në interesat e brendshme dhe rreth 798 milionë lekë në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat janë realizuar në rreth 40.3 përqind, ndërsa krahasuar me një vit më parë ato rezultojnë rreth 427 milionë lekë më të larta ose rreth 2.2 përqind më shume.




### Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes gjatë periudhës janar- qershor 2012 arritën në rreth 16.5 miliardë lekë, duke qënë rreth 3.3 miliardë lekë mbi nivelet e parashikuara. Ketu duhen mbajtur parasysh edhe përdorimet nga fondi rezerve i Këshillit te Ministrave dhe nga kontigjenca, të evidentuara më sipër.




### Shpenzimet për Subvencione

Shpenzimet për subvencione në fund të muajit qershor 2012 arritën në rreth 783 milionë lekë ose rreth 69 milionë lekë më shumë se parashikimi. Këtu duhet marrë parasysh edhe fakti i përmendur më sipër se rreth 99.6 milionë lekë janë dhënë me vendime të Këshillit të Ministrave, në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, tek njësitë e qeverisjes vendore.




### Shpenzimet për Fonde Speciale

Shpenzimet për fonde speciale gjatë periudhës janar- qershor 2012 rezultojnë rreth 2.5 miliardë lekë më pak apo rreth 4.2 përqind nën nivelin e parashikimit të periudhës. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 46.3 përqind, nga të cilat sigurimet shoqërore janë realizuar në rreth 47.3 përqind të planit vjetor, sigurimet shëndetësore në rreth 47.8 përqind. Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë rreth 2.3 miliardë lekë më të larta ose rreth 5.8 përqind më shumë ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 947 milionë lekë më të larta, ose rreth 7.3 përqind më shumë.



### Shpenzime të Pushtetit Lokal


Shpenzimet e pushtetit vendor zunë rreth 8.6 përqind të shpenzimeve korrente. Për periudhën janar- qershor 2012 ato kanë arritur në rreth 13.1 miliardë lekë nga rreth 11.4 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë të vitit 2012, duke rezultuar me një tejkalim per rreth 1.7 miliardë lekë ose rreth 14.9 përqind mbi parashikimin e periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime kanë arritur në rreth 44.3 përqind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë rreth 1.6 miliardë lekë më të ulta ose rreth 10.9 përqind më pak.



**Ndihma Sociale**


Pagesa e papunësisë është realizuar në rreth 103.5 përqind të parashikimit të periudhës, duke qënë rreth 50 përqind e parashikimit vjetor dhe rreth 75 milione leke me shumë ose 17.6 përqind më e lartë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndihma ekonomike gjatë periudhës janar- qershor 2012 rezulton rreth 884 milionë lekë më shumë ose rreth 10.7 përqind mbi parashikimin e periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 53.6 përqind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë ndihma ekonomike rezulton rreth 1,332 milione lekë më shumë ose rreth 17.1 përqind më e lartë.



**SHPENZIMET KAPITALE**

Shpenzimet kapitale deri në fund të muajit qershor 2012 janë realizuar në rreth 34.3 përqind të planit vjetor. Këtu duhet të mbahet parasysh se rreth 70.9 milionë lekë janë dhënë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për investime. Brenda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brendshëm janë realizuar në masën 56.7 përqind, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në masën 19.8 përqind të parashikimit vjetor.



Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet e brendshme rezultojnë rreth 8.6 miliardë lekë më të ulta ose rreth 35.5 përqind më pak, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 4.7 miliardë lekë më të larta ose rreth 53.7 përqind më shumë. Për rrjedhojë, investimet në total në fund të muajit qershor 2012 janë rreth 11.9 përqind më të ulta ose rreth 3.9 miliardë lekë më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

